

Ferdinant Tarazhi ka lindur më 16 korrik 1978. Aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Prej vitit 2022, ai është përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin e shërbimeve mbështetëse të institucionit, duke mbikëqyrur proceset administrative dhe logjistike në funksion të veprimtarisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Më herët, gjatë periudhës 2021–2022, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Vendore.

Në periudhën 2019–2021, ai ka drejtuar Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Tarazhi ka një eksperiencë të gjatë në fushën e financës dhe menaxhimit publik. Gjatë viteve 2010–2019 ka ushtruar detyrën e Shefit të Financës në Akademinë e Forcave të Armatosura, pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Ministrinë e Mbrojtjes.

Më herët, gjatë periudhës 2007–2010, ka shërbyer si Shef i Degës së Planifikim-Programim-Buxhetimit në të njëjtën strukturë, duke u fokusuar në hartimin dhe menaxhimin e programeve financiare dhe buxhetore.

Karrierën profesionale e ka nisur në sektorin privat si ekonomist pranë kompanisë Petrol Impeks, si dhe më herët si specialist marketing. Z. Tarazhi ka qenë gjithashtu i angazhuar në një program ndërkombëtar të Universitetit Johns Hopkins në fushën e shëndetit publik.

Ferdinant Tarazhi ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës dhe më tej ka ndjekur studimet e avancuara, duke u diplomuar me Master të Nivelit të Dytë në Financë-Bankë në Universitetin Epoka.

Ai ka ndjekur një sërë trajnimesh profesionale në fushën e financës, kontabilitetit dhe administrimit publik, përfshirë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, programimin buxhetor afatmesëm, prokurimin publik elektronik dhe menaxhimin financiar.

Z. Tarazhi zotëron aftësi të mira në menaxhim financiar, planifikim buxhetor dhe administrim institucional, si dhe ka njohuri të gjuhës angleze sipas standardit ndërkombëtar STANAG 6001.